

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7843  
E mërkurë, 24 korrik 2024  
Çmimi 0.50 €

MPJD: Konfirmohet se  
personi i vrarë në Serbi  
është Faton Hajrizi | FAQE 4



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

NUK NDALEN SULMET E PUSHTETIT NDAJ MEDIEVE. ZYRTARËT E LËVIZJES  
VETËVENDOSJE KËRKOJNË NGA PROKURORIA T'I HETOJË MEDIET

## AGK-ja I BËN THIRRJE LV-së TA NDALOJË FUSHATËN SULMUESE KUNDËR MEDIEVE | FAQE 4

office@agk-ks.org agk\_ajk agk\_ajk

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës  
Association of Journalists of Kosovo

Rr. Perandori Justinian, Nr. 29 & 30, 10000  
Prishtinë, Kosovë.

www.agk-ks.org

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) është alarmuar me fushatën e re të Lëvizjes Vetëvendosje kundër medieve në Kosovë. Duke reaguar ndaj rastit të fundit, ku zyrtarët e LV-së dhe deputetë të kësaj partie kanë shpërndarë një artikull të publikuar në faqen online të transmetuesit publik, RTK, marrë nga mediumi i Bosnjës "Slobodna Bosna", nëpërmjet të cilit akuzohen medie në Kosovë se "janë në kontroll të Serbisë dhe Vuçiçit". Ky lajm i publikuar në RTK ka ngjallur reagime të shumta edhe nga gazetarët, njohësit e medieve dhe nga liderët e partive opozitare

### AKTUALE



MCALLISTER RIZGJIDHET NË KRYE  
TË KOMISIONIT PËR POLITIKË TË  
JASHTME TË PE-së | F. 2

KURTI KRITIKON BE-NË PËR  
HEQJEN E VIZAVE PËR POSEDUESIT  
E PASAPORTAVE SERBE | F. 3

PËRURohen INVESTIMET NË  
KLINIKËN E KARDIOKIRURGJISË | F. 7

### EKONOMI



HOTI KOMENTON RAPORTIN E  
DASH-IT: KJO QEVERISJE PO E  
SHPIE KOSOVËN NË IZOLIM  
EKONOMIK DHE POLITIK | F. 8

AKP-JA ANULOI QIRATË  
E POMPAVE NË VERI  
"PËR SHKAK TË SHKELJEVE" | F. 8

### SPORT



ALPINISTJA UTA IBRAHIMI  
NGJITET NË MAJËN E FUNDIT  
8 000 METRA NË PAKISTAN | F. 10

PDK-ja: VENDIMI  
I BE-së PËR VIZAT  
ME PASAPORTA  
ILEGALE SERBE  
ËSHTË I DËMSHËM,  
QEVERIA DËSHTOI  
TA MBROJË  
INTERESIN E  
SHTETIT | F. 5



QENDRA "GJENOCIDI  
NË KOSOVË-PLAGË E  
HAPUR": BASHKËRISHT  
TA KUNDËRSHTOJMË  
SHFAJËSIMIN  
E SERBISË PËR KRIMIN  
E GJENOCIDIT! | F. 3



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjibiznesi.com](http://www.kolegjibiznesi.com)  
info@kolegjibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



## McAllister rizgjidhet në krye të Komisionit për Politikë të Jashtme të PE-së

STRASBURG, 23 KORRIK - Anëtari i Parlamentit Evropian, David McAllister, është rizgjedhur në postin e presidentit të Komisionit për Politikë të Jashtme të Parlamentit Evropian. McAllister, i cili ishte kandidati i vetëm për këtë post, u zgjodh në mënyrë unanime më 23 korrik. Pas rizgjedhjes, ai tha se ligjëvendësit evropianë po nisin mandatin e tyre në një kohë të tensioneve gjeopolitike në rritje, duke shtuar se do të vazhdojë ta theksojë rëndësinë e fqinjësisë së

afërt dhe partneritetit me shtetet e Ballkanit Perëndimor. "Ne duhet të mbajmë raporte të forta transatlantike pavarësisht se kush do të jetë në Shtëpinë e Bardhë pas janarit. Ne duhet ta frenojmë Rusinë agresive dhe të rrisim edhe më shumë mbështetjen humanitare, ekonomike, financiare dhe ushtarake për Ukrainën dhe të mbështesin rrugën e saj drejt paqes dhe anëtarësimit në Bashkimin Evropian dhe NATO. Në të njëjtën kohë, ne do të

vazhdojmë të vëmë në pah fqinjësinë tonë të afërt dhe partnerët tanë në Ballkanin Perëndimor", tha ai.

Javën e kaluar Roberta Metsola u rizgjodh kryetare e Parlamentit Evropian për një mandat prej dy vjetësh e gjysmë. Kjo është përbërja e dhjetë e Parlamentit Evropian, i cili ka 720 ulëse apo 15 më shumë se përbërja e kaluar.

Pesëdhjetë e katër për qind janë deputetë të rinj dhe 39 për qind e përbërjes së PE-së janë gra.



## Kryeministri i Malit të Zi propozon hyrjen e partive proruse në qeveri

PODGORICE, 23 KORRIK - Kryeministri i Malit të Zi, Millojko Spajiq, i propozoi Kuvendit të këtij vendi një përbërje të rikonstruktuar të qeverisë, e cila, nëse votohet, do t'i përfshijë partitë e Frontit Demokratik prorus (DF) dhe Partinë Boshnjake (BS).

Duke iu adresuar deputetëve, Spajiq tha se Mal i Zi sot është më i bashkuar se kurrë. "Kjo qeveri është garantuese e stabilitetit dhe pjekurisë. Ne jemi tregues se si serbët dhe shqiptarët, serbët dhe boshnjakët mund të jetojnë dhe punojnë së bashku", tha Spajiq. Me propozim të tij, DF-ja do t'i merret dy poste zëvendëskryeministrash dhe tre ministra.

Ky është riformatizimi i parë i



qeverisë së Spajiqit, e cila u formua në fund të tetorit të vitit të kaluar me votat e 46 deputetëve nga 81 sa janë gjithsej. Qeverinë atëkohë e mbështetën 13

deputetë të partive të DF-së, që u shpërbë së voni - përkatësisht Demokratia e Re Serbe e Andrija Mandiqit dhe Partia Popullore Demokratike e Millan Knezheviqit

- me kushtin që t'i bashkohen qeverisë këtë vit.

Politika e këtyre partive është në kundërshtim me politikën zyrtare të Malit të Zi, i cili është vend kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Këto parti mbështesin heqjen e sanksioneve kundër Rusisë - të vendosura për shkak të agresionit të saj në Ukrainë - nuk e njohin pavarësinë e Kosovës, janë kundërshtarë të anëtarësimit të Malit të Zi në NATO, mohojnë gjenocidin në Srebrenicë, mbështesin kriminelët e dënuar të luftës, Radovan Karaxhiq dhe Ratko Mlladiq etj.

Përveçse mbështesin presidentin rus, Vladimir Putin, udhëheqësit e

këtyre partive kanë marrëdhënie të ngushta politike edhe me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq, dhe me presidentin e Republikës Sërpska, Millorad Dodik.

ShBA-ja, në disa raste, ka shprehur shqetësim për përfshirjen në pushtet të partive që kundërshtojnë vlerat euroatlantike.

Shqetësime të ngjashme kanë shprehur edhe institucionet evropiane.

Megjithatë, Kuvendi i Malit të Zi ka zgjedhur Andrija Mandiqin për kryetar në fund të tetorit të vitit 2023. Ai është mbështetur edhe nga përfaqësuesit e Lëvizjes së Spajiqit Evropa Tani.

## Vejvoda: Në Ballkan nuk do të ketë ndryshime, kushdo që të bëhet president i ShBA-së

VJENË, 23 KORRIK - Fushata zgjedhore në Shtetet e Bashkuara po ndiqet me vëmendje edhe në Ballkanin Perëndimor. Edhe pse vendet e këtij rajoni nuk presin që politika amerikane ndaj tyre të ndryshojë rrënjësisht - pavarësisht se kush do të hyjë në Shtëpinë e Bardhë - secili prej tyre ka preferenca.

Ndërsa në Kosovë dhe Bosnjë-Hercegovinë, më saktësisht në entitetin e Federatës së BeH-së, duan fitoren e kandidatit/es demokrat/e, në Serbi dhe në entitetin tjetër të Bosnjës, Republika Sërpska, shumica është në favor të kundërshtarit republikan Donald Trump.

Në Mal të Zi tabloja është me shumë ngjyra, ndonëse shumica duket se anon drejt Trumpit.

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, tha pas debatit të parë midis Trumpit dhe Joe Bidenit në qershor - kur presidenti aktual amerikan ishte ende në garë për

rizgjedhje - se "Trump nuk do të mbështesë asnjë botë serbe, as nuk e kërkon dikush një gjë të tillë, por ndoshta Trumpi do të mbështeste një politikë disi ndryshe, që nuk do të ishte antiserbe".

Është plotësisht e qartë se asnjë nga vendet që janë të rëndësishme për Ballkanin Perëndimor, domethënë vendet anëtare të BE-së, ShBA-ja apo Kanadaja, nuk do ta tërheqin njohjen e pavarësisë së Kosovës dhe nuk do t'i ndryshojnë qëndrimet e tyre kryesore në politikën e jashtme, thotë për Radion Evropa e Lirë, Ivan Vejvoda, bashkëpunëtor hulumtues i Institutit për Shkenca Humane në Vjenë.

"Tani pritjet në Beograd janë më reale dhe më të matura, pa vënë baste për njërin apo tjetrin kandidat, për dallim nga kryeministri hungarez Viktor Orban, i cili është i bindur se



Trumpi do të fitojë...", thotë ai. Vendimi i fundit i autoriteteve në Serbi për t'ia dhënë dhëndrit të Trumpit, Jared Kushner, rivitalizimin e kompleksit të Shtabit të Përgjithshëm në qendër të Beogradit - pjesë të të cilit u shkatërruan gjatë bombardimeve të NATO-s në vitin 1999 - interpretohet si një

përpjekje për pozicionim më të mirë në rast se ish-presidenti Trump rikthehet në Shtëpinë e Bardhë.

Gjithashtu, Richard Grenell, i cili ishte i dërguar i posaçëm i ShBA-së për Kosovën gjatë administratës së Trumpit, është një mysafir i mirëpritur në Beograd.

Në shkurt të vitit 2023 Vuçiqi i dha medalje Grenellit me rastin e Ditës së Shtetësisë. Ai tha atëkohë se Grenelli ishte "një nga të paktët që u përpoq të kishte një qasje të balancuar dhe ta dëgjonte Serbinë". "Nëse Trumpi fiton, të gjithë thonë se Grenelli mund të bëhet sekretar i ri i Shtetit. Duke gjykuar nga numri i vizitave të tij në rajon për katër vjet, si dhe nga idetë dhe planet e ndryshme sipërmarrëse, atëherë marrëveshja me Jared Kushnerin për të ndërtuar një hotel në vendin ku është Shtabi i Përgjithshëm, do të thosha se do të mbetet ende një mundësi - sipas këndvështrimit të Trumpit dhe Grenellit - për të gjetur një zgjidhje", thotë Vejvoda. "Se çfarë forme do të ketë ajo, nëse do të kthehen në idenë e ndarjes [së Kosovës] apo do të kërkojnë mënyra të tjera, është vërtet vështirë të thuhet në këtë moment", shton Vejvoda.



## KQZ-ja miraton Rregulloren për votimin jashtë Kosovës

PRISHTINË, 23 KORRIK - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka miratuar një nga rregulloret më të rëndësishme të procesit zgjedhor

Rregulloren nr. 17/2024 Regjistrimi dhe votimi jashtë Kosovës. Sipas KQZ-së, kjo rregullore përcakton mënyrën e regjistrimit për të votuar nga jashtë Kosovës, pranimin dhe

evidentimin e dërgesave postare, procedimin dhe vlerësimin e aplikacioneve të pranuar përmes postës dhe platformës elektronike, procesin e konfirmimit dhe

kundërshtimit, votimin përmes postës, vlerësimin e dërgesave postare të pranuar përmes postës dhe votimin në përfaqësi diplomatike.



## Qendra "Gjenocidi në Kosovë - Plagë e hapur": Bashkërisht ta kundërshtojmë shfajësimin e Serbisë për krimin e gjenocidit!

PRISHTINË, 23 KORRIK - Qendra "Gjenocidi në Kosovë-Plagë e hapur" ka bërë thirrje që bashkërisht ta kundërshtojmë shfajësimin e Serbisë për krimin e gjenocidit, duke iu referuar dy rasteve të fundit, ku Gjykata Themelore në Prishtinë dënoi me 15 vjet burgim Muharrem Alidemajn për pjesëmarrje në krime lufte gjatë vitit 1999 për vrasjen e mbi njëqind shqiptarëve, në fshatin Izbicë të komunës së Skenderajt dhe me 12 vjet burgim Ekrem Bajroviqin, për pjesëmarrje në krime lufte të vrasjes së 16 shqiptarëve dhe keqtrajtimit të 84 shqiptarëve të tjerë, në komunën e Istogut. "Të dashur të mbijetuar të gjenocidit! Të dashur familjarë të viktimave të gjenocidit në Kosovë! Të dashur qytetarë të Kosovës! Të nderuar juristë, historianë dhe intelektualë të fushave të ndryshme! Të nderuar drejtues të mediave në gjuhën shqipe! Më 12 korrik 2024, Gjykata Themelore në Prishtinë, dënoi me 15 vjet burg Muharrem



Alidemajn për pjesëmarrje në krime lufte gjatë vitit 1999 për vrasjen e mbi njëqind shqiptarëve, në fshatin Izbicë të komunës së Skenderajt. Më 17 korrik 2024, Gjykata Themelore

në Prishtinë, dënoi me 12 vjet burg Ekrem Bajroviqin, për pjesëmarrje në krime lufte të vrasjes së 16 shqiptarëve dhe keqtrajtimit të 84 shqiptarëve të tjerë, në komunën e Istogut.

Duke i kualifikuar si krime lufte, aktet gjenocidale që kanë kryer forcat serbe ndaj shqiptarëve të Kosovës, gjykatat themelore të Kosovës shfajësojnë Serbinë për krimin e gjenocidit që ka kryer

gjatë luftës 1998-1999. Siç e kemi sqaruar në reagimet tona, kualifikimi i tillë ligjor i veprës është në kundërshtim të plotë me natyrën e fakteve materiale dhe paraqet shkelje të rëndë të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës", është thënë në reagimin e kësaj qendre.

Qendra "Gjenocidi në Kosovë-Plagë e hapur" në këtë reagim ka theksuar se ka alarmuar për këtë rrezik që këto vendime të përdoren nga mohuesit e gjenocidit në Kosovë si argument i jurisprudencës së gjykatave vendore, se gjoja në Kosovë nuk ka ndodhur gjenocid, por vetëm krime të shkallës më të ulët: krime lufte dhe në këtë mënyrë t'i mbyllet rruga mundësisë për ta paditur Serbinë për krimin e gjenocidit që ka kryer ndaj shqiptarëve të Kosovës. "Prandaj e shohim të domosdoshme që bashkërisht të kundërshtojmë shfajësimin e Serbisë për krimin e gjenocidit", është theksuar në reagimin e Qendrës "Gjenocidi në Kosovë-Plagë e hapur".

## Kurti kritikon BE-në për heqjen e vizave për poseduesit e pasaportave serbe



PRISHTINË, 23 KORRIK - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, e cilësoi "të padrejtë dhe të dëmshëm" vendimin e Këshillit të Bashkimit Evropian për t'ua hequr regjimin e vizave qytetarëve të Kosovës që kanë pasaporta serbe të lëshuara nga Drejtoria Koordinuese e Serbisë.

Ky vendim, sipas tij, është "edhe dekurajues për integrimin e serbëve të Kosovës". Por, shtoi Kurti, "ne nuk kemi mundësi të mëdha që të ndikojmë në vendimet e Brukselit". Kurti i bëri këto komente për gazetaret gjatë

përrimit të disa hapësirave të rinovuara në Klinikën e Kardiokirurgjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës. Ministrat e jashtëm të Bashkimit Evropian e morën vendimin e lartpërmendur më 22 korrik. Vendimi pritet të hyjë në fuqi në ditën e 20 pas botimit në Gazetën Zyrtare të BE-së. Serbët e Kosovës, që kanë pasaporta të lëshuara nga Drejtoria Koordinuese e Serbisë, janë aktualisht të vetmit qytetarë të Ballkanit Perëndimor që u duhen viza për të udhëtuar në zonën e lëvizjes së lirë, Schengen.

Komisioni Evropian propozoi heqjen e vizave për ta qysh në nëntor të vitit të kaluar.

Kosova nuk i njeh pasaportat e Drejtorisë Koordinuese të Serbisë, e cila funksionon në kuadër të Ministrisë së Brendshme serbe në Beograd, dhe mbajtësit e tyre nuk mund të fluturojnë me to nga Aeroporti i Prishtinës.

Autoritetet në Kosovë i inkurajojnë qytetarët serbë të pajisen me pasaporta të Kosovës. Qytetarët me pasaporta biometrike të Kosovës gëzojnë liberalizimin e vizave nga 1 janari i këtij viti.

## KFOR-i kryen stërvitje me qitje ajrore në Gjakovë

GJAKOVË, 23 KORRIK - Ushtarët e avionit të ShBA-së nga Komanda Rajonale Lindje, në kuadër të KFOR-it, kanë kryer stërvitje me qitje ajrore në fshatin Babaj të Bokës në Gjakovë. Përmes një njoftimi për media KFOR-i ka thënë se po vazhdon ta zbatojë mandatin e tij bazuar në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së të

vitit 1999. "Sot ushtarët e avionit të ShBA-së nga Komanda Rajonale Lindje e misionit të udhëhequr nga NATO KFOR kryen stërvitje me qitje ajrore në fshatin Babaj të Bokës, në komunën e Gjakovës. KFOR vazhdon të zbatojë mandatin e tij, bazuar në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së të vitit 1999

për të kontribuar në një mjedis të sigurt dhe të qetë dhe në lirinë e lëvizjes për të gjithë njerëzit dhe komunitetet që jetojnë në Kosovë, në çdo kohë dhe në mënyrë të paanshme", thuhet në njoftim.

KFOR-i është reaguesi i tretë për siguri pas Policisë së Kosovës dhe misionit të BE-së për sundimin e ligjit, EULEX.







office@agk-ks.org



agk\_ajk



agk\_ajk

## Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës



Rr. Perandori Justinian, Nr. 29 &amp; 30, 10000 Prishtinë, Kosovë.

NUK NDALEN SULMET E PUSHTETIT NDAJ MEDIEVE. ZYRTARËT E LËVIZJES VETËVENDOSJE KËRKOJNË NGA PROKURORIA T'I HETOJË MEDIET

# AGK-ja i bën thirrje LV-së ta ndalojë fushatën sulmuese kundër medieve

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) është alarmuar me fushatën e re të Lëvizjes Vetëvendosje kundër medieve në Kosovë. Duke reaguar ndaj rastit të fundit, ku zyrtarët e LV-së dhe deputetë të kësaj partie kanë shpërndarë një artikull të publikuar në faqen online të transmetuesit publik, RTK, marrë nga mediumi i Bosnjës "Slobodna Bosna", nëpërmjet të cilit akuzohen medie në Kosovë se "janë në kontroll të Serbisë dhe Vuçiqit". Ky lajm i publikuar në RTK ka ngjallur reagime të shumta edhe nga gazetarët, njohësit e medieve dhe nga liderët e partive opozitare

Vetëvendosja e deputetët e saj duhet të mbahen përgjegjës për nxitjen e urrejtjes dhe sulmeve potenciale kundër tyre. I bëjmë thirrje të përsëritur kryeministrit Kurti dhe Vetëvendosjes, që të mos angazhohen në fushata të tilla të papranueshme, që kanë për qëllim frikësimin e gazetarëve në Kosovë për ta bërë punën e tyre. AGK-ja, gjithashtu, shpreh keqardhje që një "lajm" si ky që sulmon kolegët ka gjetur hapësirë edhe në Lajmet Qendrore të Televizionit Publik të Kosovës.

Pas këtij reagimi të AGK-së në mbrojtje të medieve, sërish një ditë pas, të martën, ka vazhduar targetimi dhe sulmet e Vetëvendosjes kundër medieve dhe AGK-së. "Zyrtarja e Vetëvendosjes, Dejana Mihali, ka vazhduar këtë mëngjes sulmet e partisë qeverisëse kundër gazetarëve, medieve dhe AGK-së. Mihali ka kërkuar hetime ndaj medieve të Kosovës për pretendimet e gazetës boshnjake, që sipas saj, 'është një gazetë investigative, dhe nuk është një gazetë regjimesh'. Mihali gjithashtu i ka bërë thirrje AGK-së, të kërkojë hetime duke shkruar se 'Asociacioni i gazetarëve do të ishte më mirë të tregonte profesionalizëm dhe të sugjeronte hetime për rastin që

kolegët gazetarë boshnjakë kanë publikuar. Pra, nëse vërtetë Vuçiq dhe rrjeti i tij kriminal ka dorë brenda në Kosovë'. Për AGK-në, qëndrimi i fundit i Mihalit vjen në serinë e sulmeve të koordinuara të pushtetit të Vetëvendosjes kundër medieve dhe gazetarëve në Kosovë. Thirrja për hetime ndaj një shkrimi pa autor, që nuk ofron asnjë fakt e dëshmi për pretendimet e veta, është e papranueshme dhe ka për qëllim intimidimin e gazetarëve në Kosovë', është theksuar ndër të tjera në reagimin e AGK-së. E sulmet e LV-së edhe pas Dejana Mihalit nuk janë ndalur. "Nuk ndalen sulmet e pushtetit, deputeti Rrustemi i kërkon Prokurorisë të hetojë mediet", ka shkruar AGK-ja në reagimin e radhës. Sipas AGK-së, edhe deputeti Adnan Rrustemi u është bashkuar sulmeve të papranueshme kundër medieve.

Deputeti i Vetëvendosjes gjithashtu i referohet shkrimit të mediumit të quajtur 'Slobodna Bosna' për, gjoja, kontrollin e medieve të Kosovës nga ana e Serbisë. "Pyetja më legjitime që duhet shtruar është se a ka hapur prokuroria hetime për të parë nëse ka pasur transaksione financiare të Serbisë në portalet e Kosovës që shkruajnë me porosi kundër qeverisë apo çdo

qytetari të vendit tonë?", ka shkruar Rrustemi në "Facebook".

AGK-ja ka thënë se edhe sulmi i deputetit Rrustemi është i papranueshëm dhe ka për synim intimidimin e medieve dhe gazetarëve.

AGK-ja i ka bërë thirrje LV-së ta ndalojë fushatën sulmuese kundër medias.

Disa gazetarë të RTK-së janë distancuar nga "lajmi" i RTK-së, ku Nacionale e Periskopi u portretizuan si media të paguara nga Serbia duke cituar një portal nga Bosnja.

Flutura Kusari, juriste e së drejtës së medias, ka theksuar se dëmi që i është bërë kredibilitetit të RTK-së është vështirë i rikuperueshëm. "Vetëm shkarkimet sot. Asnjë ditë me vonë. Të të gjithë personave përgjegjës do të ndihmonin sado pak. Ju lumtë gazetarëve që po distancohen nga politika redaktoriale e RTK-së, politike kjo që e ka lejuar propagandën e LV-së për ta helmuar publikun me informacione të kontaminuara", ka shkruar Kusari në "Facebook".

Sekretarja e përgjithshme e PDK-së, Vlora Çitaku, duke reaguar rreth kësaj ngjarjeje, ka shkruar në "Facebook": "Tjetër ditë - tjetër sulm i qeverisë dhe eksponentëve të saj ndaj medieve dhe

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 23 KORRIK - Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) ka theksuar se është alarmuar me fushatën e re të Lëvizjes Vetëvendosje kundër medieve në Kosovë. Deputetët Sali Zyba dhe Dimal Basha kanë shpërndarë një artikull të një mediumi të quajtur "Slobodna Bosna" (shqip: Bosnja e Lirë), nëpërmjet të cilit ata akuzojnë medie në Kosovë që, sipas tyre, "janë në kontroll të Serbisë dhe Vuçiqit". Deputeti Zyba në "Facebook" shkruan: "Dy medie të Kosovës iu përmendën emra, Periskopit dhe Nacionales". Të dy deputetët, dhe

eksponentë të tjerë të Vetëvendosjes, kanë shpërndarë një artikull të publikuar në faqen online të transmetuesit publik, RTK, që pa autor, ka përkthyer tekstin e mediumit boshnjak. Shkrimi i "Slobodna Bosna" bazohet në burimet dhe në deklaratat e një individi kontrovers, me emrin Boban Bogdanoviq, që thotë se është disident politik serb. AGK-ja dënon fuqishëm këtë fushatë të rrezikshme dhe të papranueshme të deputetëve të partisë qeverisëse, Vetëvendosje, që i targeton këto dy medime dhe gazetarët që punojnë aty. Fushata si kjo e rrezikojnë seriozisht sigurinë e gazetarëve të këtyre dy medimeve dhe

# Asnjë qeveri nuk mund ta fitojë betejën me mediet, sulmet e orkestruara të rrezikshme dhe të dëmshme



Nga Musa SABEDINI

Kam shkruar edhe më herët për ndikimin dhe presionin apo kërcënimet e shantazhet e shumta që po bëhen nga Qeveria, deputet, aktivist e simpatizant me natyrë kriminale nën ombrellën e LV, ndaj medieve dhe do të jem shumë i shkurtër kësaj radhe. Asnjë Qeveria, asnjë zyrtar apo deputet nuk mund ta fitojë betejën me mediet e lira, të pavarura dhe

profesionale.

Në të gjitha rrethanat i kam përkrahur mediet e sinqerta dhe të ndershme dhe edhe këtë herë jam në mbrojtje të tyre, duke kërkuar që institucionet e Kosovës të ndalin këtë turr e këtë urrejtje kundër punës së gazetarëve të të gjitha medieve. Është momenti i fundit që Albin Kurti ta kuptojë seriozitetin që përçojnë mediet kosovare, ta

kuptojë njëherë e përgjithmonë se mediet e lira e të profesionalizuara janë shtylla e zhvillimit dhe avancimit të demokracisë në botë.

Unë nuk pres diçka të mirë apo pozitive kur i shoh këta argatët e LV teksa sulmojnë prokuror e gjykatës, hetues policor e gazetar të ndershëm, e të përkushtuar.

Këto fushata të përcjella me presione, e shantazhe, dëmin më

të madh ia bëjnë partisë në pushtet, askujt tjetër, kurse mediat duhet të jenë më solidare me njëra tjetrën sepse vetëm kështu fitohet beteja ndaj Qeverisë, që po përçon vetëm arrogancë e pasiguri. RTK-ja me gjestin e fundit dëshmoi se është larg standardeve profesionale.

(Autori është ligjërues në Degën Media dhe Komunikim në UBT)

## PDK-ja: Vendimi i BE-së për vizat me pasaporta ilegale serbe është i dëmshëm, qeveria dështoi ta mbrojtë interesin e shtetit

EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 23 KORRIK - Nënkrjetarja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Mimoza Ahmetaj, ka shprehur pakënaqësi lidhur me vendimin për liberalizimin e vizave të qytetarëve serbë të Kosovës, të cilët kanë pasaporta të lëshuara nga institucionet ilegale serbe, respektivisht nga Drejtoria Koordinuese e Serbisë.

Ahmetaj, në një konferencë për medie, tha se ky vendim që e vendos në pikëpyetje sovranitetin e Kosovës dhe nxit vetëm veprimin e strukturave paralele ilegale serbe, është rezultat i paaftësisë së qeverisë Kurti. "PDK-ja ka pritur nga Bashkimi Evropian që ta mbështesë Kosovën në qëllimin e saj për integrimin e serbëve të Kosovës brenda institucioneve legjitime të shtetit tonë, që ata të pajisjen me dokumente zyrtare të Kosovës. Ky vendim kontribuon vetëm në distancimin e serbëve të Kosovës dhe inkurajon ata që të mos bëhen pjesë përbërëse e shoqërisë dhe shtetit të tonë. Megjithatë, edhe ky vendim ndërkombëtar që vjen sot si pasojë për Kosovën, dje e kishte një shkak vendor: Qeverinë e Kosovës! Që nga dita e parë e qeverisjes pushteti aktual ka pasur një qasje joserioze ndaj dialogut dhe aleatëve tanë. Kjo qeveri ka treguar paaftësi dhe papërgjegjësi të thellë në veprimet dhe mosveprimet e saj



në politikën e jashtme, përmes të cilave po vërtetohet sot se ka dëmtuar edhe interesat e vendit tonë", tha ajo.

Ahmetaj theksoi se qeveria Kurti nuk ka reaguar në kohë dhe nuk ka insistuar sa duhet që të respektohet marrëveshja e

arritur në dialog për lëvizjen e lirë. "Politikat e gabuara të kësaj qeverie, të cilat gjithmonë janë reaktive, por asnjëherë aktive, nuk kanë arritur të mbrojnë në asnjë rast interesat e vendit tonë dhe as ta shtyjnë përpara agjendën e shtetndërtimit dhe

konsolidimit të Kosovës. Qeveria jonë, fatkeqësisht, nuk e ka kuptuar akoma se komentet e saj të vakëta brenda katër mureve në Prishtinë, janë zë i shurdhër në institucionet e Bashkimit Evropian", shtoi Ahmetaj. PDK-ja vlerëson se ky vendim i

BE-së dhe kjo qasje e qeverisë rikonfirmojnë se qeveria Kurti është strukturë në Prishtinë që ka zero komunikim me partnerët dhe aleatët ndërkombëtarë, se ia ka mbyllur Kosovës linjat e komunikimit dhe mirëbesimit në të gjithë botën, si dhe e ka izoluar Kosovën. "Këto vendime nuk i kontribuojnë normalizimit të raporteve mes Kosovës dhe Serbisë. Përkundrazi, e cenojnë integritetin territorial dhe institucionet të Kosovës dhe dërgojnë mesazhe tjera, të cilat, në vend të promovimit të stabilitetit nxisin edhe me tutje politikën cenuese të Serbisë ndaj Kosovës në veçanti, e Ballkanit në përgjithësi. Para 14 vitesh, kur Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë vulosi shpalljen e Pavarësisë së Kosovës, e gjithë bota demokratike ishte me Kosovën dhe të drejtën e saj për shtet. Sot, 14 vite më vonë, nën udhëheqjen e papërgjegjshme dhe pa vizion të kësaj Qeverie, bota është larguar nga ne dhe Kosova po shkon drejt humbjes së momentumeve të rëndësishme për integrim e zhvillim", tha Ahmetaj.

Po ashtu, nënkryetarja Ahmetaj ka dënuar ashpër sulmet e njëpasnjëshme që po u bëhen nga ky pushtet medieve të lira dhe gazetarëve. "Kjo është e papranueshme dhe kërkojmë që menjëherë të ndalen këto tendenca jodemokratike të qeverisë kundër jush. Fjala e lirë është parakusht i një shteti demokratik që nuk guxon ta cenojë askush", tha ajo.

gazetarëve. Demokracia dhe media e lirë shkojnë së bashku, prandaj duket se kësaj qeverie nuk po i intereson as njëra dhe as tjetra. E dhimbshme me pa këtë tendencë të pushtetit me shtyp çdo fjalë dhe çdo mendim ndryshe. E frikshme!". Për këtë rast ka reaguar edhe Lidhja Demokratike e Kosovës

(LDK). Sipas kësaj partie, Radio Televizioni i Kosovës (RTK) është dorëzuar tërësisht. "Mediumi i presupozuar si publik, është shndërruar në vegël të interesit ordiner të pushtetit. RTK jashtë çdo morali e etike godet mediat e Kosovës, iu bën gjyqin publik dhe i dënon me epitelin e tradhtarit e shërbëtorit të

interesave të huaja. LDK-ja e ka dëshmuar tash e dy vjet, nëpërmjet bojkotit të plotë se ky medium i thirrur për të përfaqësuar interesin publik dhe promovuar liritë, është shndërruar fatkeqësisht në Bastillen e fjalës së lirë. Në RTK shtypet e vërteta dhe konstruohet propaganda. Reagimet e koordinuara me zyrat

partiake e pushtetare, ndërsa, të shfaqura qartazi tashmë, dëshmojnë kapjen e thellë të mediumit publik. Dhe ky është vetëm fillimi sepse kur sulmohen mediat është shenjë se shpifjet, frikësimet do bëhen edhe më të shpeshta e të dukshme edhe ndaj kundërshtarëve të pushtetit. Prandaj reagimi ynë i përbashkët është domos-

doshmëri! LDK-ja do të shfrytëzojë mekanizmat parlamentar për të vënë në dritë kapjen dhe për t'i mbajtur përgjegjës kapësit dhe shërbëtorët e propagandës. Për më tepër bashkë me qytetarin e Kosovës do ta mbrojmë fjalën e lirë dhe interesin publik në këtë vend me çdo çmim!", është theksuar në reagimin e LDK-së.



## BE-ja: Ura e Ibrit, çështje e dialogut. Palët të përmbahen nga veprimet e njëanshme të pakoordinuara

PRISHTINË, 23 KORRIK - Zëdhënësi i BE-së, Peter Stano, ka deklaruar të martën se rihapja e urës në Ibër, për Bashkimin Evropian është çështje e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë dhe se çdo vendim për hapjen e saj

duhet të merret në kuadër të negociatave. "Bisedimet janë duke vazhduar dhe BE-ja po bashkëpunon ngushtë me partnerët e saj ndërkombëtarë në Kosovë. BE-ja u bënë thirrje të gjitha palëve të interesuara që të

përmbahen nga çdo veprim i pakoordinuar dhe i njëanshëm", tha Stano. Siç shton ai, citon kosovo-online, të gjitha marrëveshjet nga dialogu, përfshirë edhe ato për urën në Ibër, duhet të zbatohen plotësisht.



## MFRR-ja e shqetësuar për Ligjin për KPM-në miratuar nga Kuvendi

PRISHTINË, 23 KORRIK - Partnerët e konsorciumit të nënshkruar për Reagimin e Shpejtë për Lirinë e Medias (MFRR) kanë shprehur shqetësim lidhur me Ligjin për Komisionin e Pavarur të Medieve të miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Në kumtesë thuhet se ky ligj nuk plotëson standardet ndërkombëtare për shprehjen e lirë dhe kërcënon lirinë e medias, duke përfshirë dhënien e autoriteteve për një kontroll më të madh mbi rregullimin e medias. MFRR-ja i bëri thirrje gjykatës ta përdorë mandatin e saj për ta shfuqizuar ligjin dhe për t'i mbrojtur të drejtat themelore. Gjithashtu, thirrje iu bë presidentes Vjosa Osmani, që ta dënojë publikisht ligjin dhe ta ritheksojë përkushtimin e saj për promovimin dhe ruajtjen e lirisë së medieve në Kosovë.

Në komunikatë thuhet se shqetësimet kryesore në lidhje me ligjin lidhen me ndikimin e mundshëm në pluralizmin e medias, pavarësinë dhe peizazhin më të gjerë rregullator që qeveris organet mediatike në vend. "Legjislacioni i propozuar përfshin disa dispozita të diskutueshme: Ndikim më i madh politik në organin rregullator: i themeluar me ligj si "organ i pavarur për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit", KPM-ja megjithatë tashmë është subjekt i ndikimit politik. Pasi që zgjidhen nga Parlamenti i Kosovës (ku LVV aktualisht mban 51% të vendeve), anëtarët e KPM-së shpesh i shërbejnë agjendës së tyre politike. Zgjerimi i bordit të KPM-së nga 7 në 11 anëtarë, rritja e mandatit të tyre deri në tetë vjet dhe



mundësia e Kuvendit për shkarkimin e bordit në rast të humbjes së besimit, të gjitha të planifikuara në projektligj, do të rrisin potencialin për kapja politike, duke mundësuar ndikim edhe më të madh të qeverisë mbi rregullimin e medias. Në të njëjtën kohë, Këshilli i Mediave të Shkruara

të Kosovës (i cili përbëhet nga përfaqësues të mediave) do të dobësohet pasi një pjesë e mediave online do të rregullohet nga KPM-ja. Regjistrimi i mediave online: ligji i ri kërkon që KPM-ja të regjistrojë mediat bazuar në një përkufizim të ri të mediave online që nuk ekziston në ligjin e BE-së, sipas

opinionit ligjor të Këshillit të Evropës. Kjo krijon pasiguri ligjore për mediat online. Gjohet për shkeljen e rregullave sipas projektligjit të ri: propozimi legjislativ përcakton gjoha që variojnë nga 200 deri në 40,000 euro për mediat që shkelin dispozitat e tij, por nuk ka specifikë se cila kundërvajtje korrespondon me cilën shumë të saktë. Kjo ngrë shqetësime rreth dënimeve arbitrare dhe të tepruara që mund të heshtin zërat kundërshtues. Heqja e klauzolës së barazisë gjinore: projektligji heq kërkesën e mëparshme ekzistuese për të paktën dy gra në bordin e KPM-së, duke shkelur Ligjin për Barazi Gjinore të vitit 2015 dhe duke ngritur shqetësime të mëtejshme për përfaqësimin në media", është theksuar në komunikatën për medie të MFRR-së.

## Policia kryen bastisje në 10 lokacione të ndryshme dhe arreston persona të dyshuar

**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 23 KORRIK - Policia e Kosovës, respektivisht Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit, të martën ka zbatuar urdhëresën e gjykatëse kompetente, ku janë bastisur 10 lokacione të ndryshme, 8 prej tyre në regjionin e Pejës dhe 2 në regjionin e Prishtinës, me dyshimin e bazuar se kanë kryer veprat penale 'keqpërdorim i detyrës zyrtare', 'marrje e ryshfetit', 'marrje e ryshfetit në sektorin privat' dhe 'legalizim i përmbajtjes së rreme' nga ana e të dyshuarve. Personat e dyshuar, gjashtë prej



tyre persona zyrtarë nga Departamenti i Patentshoferëve në Ministrinë e Infrastrukturës, duke bashkëvepruar, dyshohet se

kanë vepruar jashtë rregullorevë dhe udhëzimeve të Ministrisë së Infrastrukturës, duke organizuar provime për marrjen e patentë-

shoferëve jashtë orarit zyrtar të punës, duke përdorur metodën e testimave në formë fizike dhe duke mos i përfillur format zyrtare elektronike. "Dyshohet se testet janë plotësuar në emër të kandidatëve nga ana e zyrtarëve të njësive së patentë-shoferëve në Pejë dhe të njëjtat në mënyrë të kundërligjshme janë futur në sistem nga ana e zyrtarit të IT-së. Po ashtu, tre të dyshuar, pronarë të autoshkollave, dyshohet se kanë rekrutuar kandidatë dhe kanë siguruar dokumentacion duke falsifikuar dokumentet e nevojshme, me qëllim të futjes së tyre në provim", ka njoftuar Policia e Kosovës. Sipas njoftimit, gjatë operacionit


poligor të bastisjes janë sekuestruar dëshmitë: 7 800 euro, gjashtë telefona mobilë, si dhe materiale të ndryshme lidhur me testimet e kandidatëve. Lidhur me rastin personat e dyshuar janë intervistuar në praninë e avokatëve të tyre mbrojtës dhe me vendim të prokurorit të lëndës, 6 prej tyre u është shqiptuar masa e ndalimit prej 48 orësh dhe një person i dyshuar është liruar në procedurë të rregullt për shkaqe shëndetësore. Për tre nga të dyshuarit e përfshirë në rast, të cilët nuk janë hasur, Policia e Kosovës do të ndërmarrë veprime të nevojshme për sigurimin e pranisë së tyre.

## Katër milionë euro për pishinën gjysmolimpike në Podujevë

PODUJEVË, 23 KORRIK - Të martën është nënshkruar memorandum mirëkuptimi për financimin e projektit të pishinës gjysmolimpike në Podujevë. Kryetari i komunës, Shpejtim Bulliqi, ka thënë me këtë rast se sot është bërë edhe hapi i radhës drejt finalizimit të këtij projekti që kap vlerën e katër milionë eurove. "I lumtur që sot e bëmë hapin e madh drejt finalizimit të një projekti tjetër të madh në vlerë prej 4 milionë eurove siç është Pishina

gjysmolimpike. Pas vendimit për caktimin e lokacionit kohë me parë dhe hartimit të projektit, sot në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit nënshkruam memorandumin e mirëkuptimit për bashkë-financimin e këtij projekti aq të nevojshëm për sportdashësit dhe ata që e duan notin", është shprehur Bulliqi. Sipas këtij memorandumit të mirëkuptimit, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit do të finançojë 3.5 milionë euro, kurse komuna e Podujevës 500

mijë euro. Projekti përfshin pishinën kryesore, pishinën për fëmijë dhe hapësirën e gastronomisë. Sipas Bulliqit, kjo pishinë, përveç që do të bëhet adresa ku do të zhvillohen gara ndërkombëtare e vendore në not, ajo do të mund të shfrytëzohet edhe për stërvitjen e sportistëve dhe rekreacion nga qytetarët e Podujevës. Projekti është trevjeçar dhe përfshin vitet 2024, 2025 e 2026.





## Oficerët doganorë parandalojnë tentimin për futjen e mallrave ilegale

PRISHTINË, 23 KORRIK - Në terminalin doganor në Mitrovicë janë deklaruar për zhdoganim disa dërgesa. Malli i deklaruar përbëhej nga "motoçikleta kuad me katër rrota", të cilat ishin të ngarkuara në automjetin bartës. Gjatë kontrollimit fizik të

pakove me gjëra personale jokomerciale, zyrtarët doganorë kanë zbuluar mallra të ndaluara, përfshirë shpata luftarake pesë copë, thikë rreth 20 cm e gravuar, revole me gaz marka 'Colt Government 1911 A1' me katër paketime kapsulla metalike 4.5 mm -1 copë, 50

copë mbushje me gaz 12 gram CO2. Rasti i është dorëzuar Policisë së Kosovës për hetime të mëtejshëm. Dogana e Kosovës mbetet e përkushtuar për zbatimin e ligjit dhe mbrojtjen e sigurisë publike, duke siguruar që asnjë mall i ndaluar të mos kalojë përmes kufijve.



## MPJD: Konfirmohet se personi i vrarë në Serbi është Faton Hajrizi

PRISHTINË, 23 KORRIK - Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës njoftoi se është konfirmuar se shtetasi i Kosovës, Faton Hajrizi, është personi që është vrarë nga autoritetet e Serbisë më 19 korrik. Përmes një njoftimi për medie, MPJD tha se autoritetet serbe më 22 korrik kanë dërguar tek autoritetet e Kosovës shenjat e gishtërinjve të një personi dhe se të njëjtat shenja, së bashku me shenjat e gishtërinjve të Hajrizit, janë dërguar për ekzaminim në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë. "Pas krahasimit, Drejtoria e Bashkëpunimit Ndërkombëtar Policor - ILECU e Policisë së Kosovës ka pranuar përgjigje se këto gjurmë i përkasin qytetarit të raportuar si i vrarë, Faton Hajrizi", u tha në njoftim.

Hajrizi, i arratisur nga një burg në Kosovë, sipas autoriteteve serbe, vrau një polic serb dhe plagosi një tjetër në orët e para të 18 korrikut në Lloznicë, qytet në pjesën perëndimore të Serbisë.

Pasi më 19 korrik, Serbia



pretendoi se Hajrizi u vra, autoritetet e Kosovës kërkuan që të konfirmohet identiteti i personit të vrarë.

Ministri i Punëve të Brendshme i Serbisë, Ivica Dačić, tha se dorasi i dyshuar i policit u vra në vendin e quajtur Banja Kovilaça,

pasi autoritetet serbe kishin qenë në kërkim të tij që nga vrasja e policit. Sipas tij, ai ishte fshehur buzë lumit Drina, duke kërkuar një mënyrë për ta kaluar atë.

Serbia ka kërkuar që Gjermania ta ekstradojë vëllanë e Fatonit,

Artanin, pasi në vendin e ngjarjes janë gjetur dokumente në emër të tij.

Hajrizi dyshohet se kishte udhëtuar nëpër Serbi me dokumentet e vëllait të tij. Artani është paraqitur para autoriteteve në Gjermani ku dhe

jeton dhe ka thënë se i vëllai, Fatoni, ia kishte vjedhur pasaportën gjatë kësaj jave në Gjermani. Megjithatë, nuk është konfirmuar nëse Fatoni ka qenë në Gjermani.

**Vrasja e Faton Hajrizit, Kurti: Kam shumë punë si kryeministër, nuk kam nevojë ta bëj edhe punën e ministrit**

Kryeministri i vendit, Albin Kurti, është deklaruar të martën rreth rastit të Faton Hajrizit, i cili më 19 korrik u raportua se është vrarë në Serbi. Gjatë një vizite që ia bëri QKUK-së, Kurti para medieve tha se në lidhje me këtë rast janë duke u marrë dy dikastere qeveritare. "Dy ministri tona, e Punëve të Brendshme dhe e Drejtësisë po e trajtojnë këtë rast. Nuk kam nevojë ta bëj edhe punën e ministrit. Besoni se kam shumë punë si kryeministër", tha kryeministri Kurti.

## Përurohen investimet në Klinikën e Kardiokirurgjisë



Prishtinë, 23 korrik - Të martën është bërë përrurimi i renovimeve në Klinikën e Kardiokirurgjisë. Me këtë rast kryeministri Albin Kurti, i cili ishte i pranishëm aty, në "Facebook" ka shkruar se ky vit është vit i transformimit të shëndetësisë publike. "Pas Klinikës së Urologjisë, radha i erdhi Klinikës së Kardiokirurgjisë. Me investimet e bëra, që i përuroam sot, ka 9 shtretër më shumë, dhoma të kujdesit

intensiv dhe salla operative sipas standardeve më të larta, filtra për eliminimin e infeksioneve intrahospitalore, banjo e nyje sanitare moderne, hapësira të ripërtërita e të riorganizuara të sportelit dhe të pritjes, si dhe hapësirë të re për depo të barnave, arkiva dhe zyre për stafin shëndetësor. Ajo tash është në mesin e Klinikave më të bukura të ShSKUK-së. Ky vit, është vit i transformimit të shëndetësisë publike", ka shkruar kryeministri Kurti.

## Kurti në Henc, bashkë me fotografë të shpezëve, kafshëve të egra dhe natyrës

PRISHTINË, 23 KORRIK - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, ka vizituar të martën Ligatinën e Hencit, bashkë me 15 fotografë, të cilët pasqyrojnë përmes fotove botën e kafshëve të egra dhe natyrën e vendit tonë.

Teksa pa nga afër mënyrën e tyre të punës dhe formën se si operojnë, kryeministri u njoh me sfidat me të cilat ata përballen në vendin e punës dhe rreziqet të cilat mund të shfaqen. Kryeministri Kurti shprehu vullnetin dhe gatishmërinë e

qeverisë për adresimin e këtyre sfidave në mënyrë që puna e tyre të jetë më produktive dhe lehtë e përballueshme. Ai i falënderoi fotografët për punën e kontributin e tyre në fushën e fotografisë dhe dokumentimit të botës së egër në vendin tonë.





# Hoti komenton raportin e DASH-it: Kjo qeverisje po e shpie Kosovën në izolim ekonomik dhe politik

**EPOKA E RE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 23 KORRIK - Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka komentuar të gjeturat e raportit të DASH-it lidhur me klimën e investimeve në Kosovë në vitin 2024. Në "Facebook", Hoti ka shkruar se ajo që është shqetësuese është mungesa totale e reformave ekonomike në këto vite, duke rezultuar me përkeqësim të ambientit biznes dhe investime. "Raporti i DASH-it i publikuar këto ditë ofron një përmbledhje objektive dhe të paanshme të klimës së investimeve në Kosovë më 2024. Sigurisht se Kosova ka sfida afatgjate në fushën e ekonomisë, të lidhura me zhvillimet politike që marrin kohë për t'u adresuar. Por ajo që është shqetësuese është mungesa totale e reformave ekonomike në këto vite, duke rezultuar me përkeqësim të ambientit biznes dhe investime. Nisur nga kapacitetet e kufizuara të Kosovës për financim të investimeve në shkallë të gjerë e në teknologji moderne, investimet e jashtme janë thelbësore për të siguruar rritje më të lartë ekonomike dhe për të sjellë teknologjinë më të re", ka shkruar Hoti.

Ai ka thënë se, fatkeqësisht, politikat ekonomike në këto katër vjet të qeverisjes po e shpijnë Kosovën në izolim ekonomik e politik, në krijimin e një lloj varësie sociale, pa insentiva për biznes e inovacion, ku promovohen skemat sociale si shpëtim për familjet në nevojë e jo punësimi dhe zhvillimi i sektorit privat. "Ja disa nga të gjeturat problematike të raportit të DASH-



it: 1. Politikat kryeneçe të Qeverisë në fushën e ekonomisë, ndërhyrjet politike në ekonomi, dhe dialogu i kufizuar publiko-privat përbëjnë sfida për investitorët; 2. Rregulloret e ndryshme qeveritare miratohen pa debat domethënës me ata të cilët preken nga ato rregullore; 3. Komunikimi i sektorit privat me qeverinë është i pamjaftueshëm; 4. Rritja ekonomike dhe produktiviteti kufizohen nga ekonomia informale, sidomos në sektorët si ndërtimtaria, bujqësia e tregtia me pakicë; 5. Fuqia punëtore e re e Kosovës mbetet e pashfrytëzuar për shkak të mospërputhjes me atësitë që ka fuqia punëtore dhe aftësitë të kërkuara nga punëdhënësit; 6.

Agjencia për Regjistrim të Bizneseve e suspendoi për një kohë licencën e transmetuesit më të madh media në Kosovë; 7. Lëndët komerciale në gjykatë marrin nga 6 muaj deri në disa vite për tu zgjidhur; 8. Regjistrimi i markës tregtare merr 9 muaj kohë; 9. Miratimi i licencës merr 18 muaj kohë; 10. Aktiviteti bankar është i kufizuar nga kushtet e rënduara ekonomike, fuqizimi i dobët i kontratave etj.; 11. Kosova vazhdon të prodhojë 95% të energjisë me thëngjill përmes termocentraleve të ndërtuara në vitet 1960 dhe 1980; 12. Më 31 dhjetor 2020, Kosova e ka nënshkruar Marrëveshjen për Insentiva për Investime, e cila ka hyrë në fuqi më 3 shkurt 2021 (në

qeverinë paraprake), e cila e ka bërë Kosovën vendin e parë në Ballkanin Perëndimor që nënshkruan një marrëveshje të tillë", ka shkruar Hoti.

Ai ka thënë se është e kuptueshme se disa nga këto sfida nuk mund të zgjidhen brenda një mandati qeverisës. "Problemi është se as nuk janë bërë përpjekje për t'u zgjidhur. Përkundrazi, situata është përkeqësuar. Problematike në fushën e ekonomisë nga këndvështrimi i investitorëve është mungesa e parashikueshmërisë në politika ekonomike. Me këtë qeveri asgjë nuk është e sigurt. Brenda natës mund të ndodhin ndryshime në kursin e veprimeve. Mund të zgjohemi në mëngjes dhe të

kuptojmë se dikujt iu ka suspenduar licenca, dikujt tjetër i është shqiptuar dënim nga autoritetet tatimore, dikujt iu ka sekuestruar pasuria etj", ka theksuar Hoti.

Ai ka thënë se edhe kur shteti ka të drejtë në veprimet që ndërmer, e rëndësishme është zbatimi me shumë kujdes i burokracisë ligjore për ndërmarrjen e veprimeve dhe sigurimi i transparencës së plotë. "Është e qartë se qeverisja ekzistuese nuk e ka këtë qëllim. Në veprimet e veta kjo qeverisje motivohet nga qëllimet politike të ndjekjes së atyre që i quan oligarkë, të cilët fillimisht i ka shpallur armiq të shtetit e të popullit", ka thënë deputeti i LDK-së, Avdullah Hoti.

## AKP-ja anuloi qiratë e pompave në veri "për shkak të shkeljeve"

PRISHTINË, 23 KORRIK - Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) tha se pronarët e pompave të mbyllura të karburanteve në komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës kanë shkelur kontratat e qirasë për shkak se nuk kanë respektuar një klauzolë që ka të bëjë me marrjen e licencës për punë me derivate të naftës. Për këtë arsye, sipas AKP-së, janë ndërmarrë veprime për ndërprerjen e atyre kontratave. Në deklaratën dhënë "Radios Evropa e Lirë", AKP-ja shpjegoi se pompat e mbyllura të karburanteve janë në pronësi të saj - si trashëgimi e ndërmarrjeve të dikurshme shoqërore "INA Trgovina" nga Zagrebi dhe "Jugopetrol" i Beogradit - dhe se ajo ka të drejta ekskluzive për t'i

menaxhuar ato.

Agjencia tha se kishte kontrata qiraje, të vlefshme dy vjet, me biznesmenë nga veriu i Kosovës, por nuk specifikoi se kur ishin nënshkruar ato.

Javën e kaluar Inspektorati i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë në Qeverinë e Kosovës mbylli pesë pompa të karburanteve në veri, pasi që, siç u tha, pronarët nuk kishin licenca për punë.

Sipas njoftimit të kësaj ministrie më 22 korrik, të gjitha subjektet afariste që merren me shitjen e derivateve të naftës duhet të kenë licenca, ndërsa ndaj atyre që shkelin ligjin do të merren "masa të rrepta ndëshkuese".

Ministria kompetente tha se inspektimi do të vazhdojë edhe në

ditët në vijim, për të kontrolluar nëse pikat e karburanteve kanë licenca të vlefshme për aktivitetin që ushtrojnë.

Katër nga pesë pompat e mbyllura kishin logon e "NIS Petrol", apo Industrisë së Naftës së Serbisë, që besohet se ka rifilluar punën e saj në Kosovë në dhjetor të vitit 2016. Përndryshe, NIS është kryesisht në pronësi të "Gazpromneft"-it rus dhe kompanisë së tij ombrellë, "Gazprom". Megjithatë, sipas informacioneve të AKP-së dhe Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ato pompa ishin në pronësi të biznesmenëve nga veriu i Kosovës.

AKP-ja tha se asnjëherë nuk ka pasur ndonjë komunikim apo kontratë me "NIS Petrol".





# Tre luftërat e Izraelit kundër oktapodit iranian



“Irani ka shumë tentakula. Në Gaza, po luftojmë njëherën. Por ne po luftojmë në vende të ndryshme dhe kjo kërkon përpjekje maksimale, kundër çdo tentakule”. Kështu e paraqiti luftën globale gjenerali Herzi Halevi, gjatë një takimi me ushtarët në Tel Aviv.

Pas 290 ditësh luftë, sulmi në portin jemenas të Hodeidës hapi një front të katërt dhe i bëri perspektivat e luftës edhe më të afërta. Ndërsa roli i Teheranit në nxitjen e sulmeve është i sigurt, realiteti i konfliktit është më kompleks. Çdo armik ndjek objektiva dhe logjika të ndryshme, shpesh autonome nga drejtimi i ajatollahëve. Izraeli përballet me një sfidë të papërbërë më parë në historinë e tij ushtarake, e karakterizuar nga fushata të shkurtra dhe mbështetje e qartë nga aleatët, veçanërisht SHBA.

Lufta që nisi pas masakrës xihadiste të 7 tetorit teston aftësitë jo vetëm të forcave të

armatosura, por të të gjithë vendit. Objektivat dhe strategjitë ushtarake mbeten të papërcaktuara, e vetmja siguri është një mobilizim zjarri që nuk njuh pauza dhe vazhdon i pandërprerë.

Në Rripin e Gazës, operacionet vazhdojnë ndërsa negociatat për armëpushim dhe lirim të pengjeve janë në një fazë konfuze. Ushtria kryen sulme kundër Hamasit në zonën Rafah dhe ndërhyrje vazhdimisht në qendrat urbane, të cilat tashmë i kontrollon.

Sulmi i përgjakshëm kundër Mohammed Deif, liderit ushtarak të grupit terrorist, tregon se nuk ka zona të lira për popullatën palestineze. Struktura e Hamasit ka pësuar goditje të tmerrshme, por nuk është asgjësuar. Udhëheqësi Yahya Sinwar mbetet i lirë dhe aktiv.

Një pjesë e konsiderueshme e tuneleve nuk u shkatërruan, edhe nga frika e ekzekutimit të pengjeve. Më shumë se nëntë

muaj pas hyrjes së trupave izraelite, nuk ka asnjë plan për të ardhmen e Rripit të Gazës, që do të riorganizimin e militantëve dhe rekrutimin e anëtarëve të rinj.

Një pjesë e konsiderueshme e burimeve të luftës izraelite mbetet e përqendruar në Frontin Jugor: mesatarisht gjashtë brigada, bashkë me burimet më të mira të inteligjencës dhe aviacionit. Një situatë që e bën edhe më të vështirë çdo vendim për kufirin libanez.

Dueli me Hezbollahun bëhet çdo ditë më i ashpër dhe më i dhunshëm: në çdo moment mund të kthehet në luftë të hapur. Shtabi izraelit dëshiron të shmangë një konflikt të dyfishtë tokësor, por ka frikë nga zgjatja e konflikteve në fronte të shumta.

Ushtarët izraelitë janë pothuajse të gjithë rezervistë dhe përvoja në Gaza e ka bërë të qartë se ata mund të luftojnë maksimumi dy deri në tre muaj. Hezbollahu është

një kundërshtar shumë më i fuqishëm se Hamasi dhe po e vërteton atë me arsenalin e madh raketor dhe taktikat inovative.

Hezbollahu ka të paktën dhjetë mijë veteranë nga Siria, të pajisur mirë dhe me dëshirë për t'u martirizuar. Nëse në Gaza izraelitët, të kapur në befasi, nuk kishin një plan për ofensivën apo informacion të përditësuar, ata janë duke u përgatitur në këtë front për të paktën tetë vjet me njësi të specializuara.

Ata kanë harta të tuneleve nëntokësore dhe i njohin planet organizative të ushtrisë shiite. Për muaj të tërë kanë kryer sulme kundër njerëzve kyç dhe bastisje në instalimet më të rëndësishme. Ekziston edhe një element parandalues: Sinwar përdor popullsinë si mburojë.

Nasrallah ka mbrojtur gjithmonë konsensusin e komunitetit shiit dhe të të gjithë Libanit. Udhëheqësi suprem i Hezbollahut e merr

seriozisht kërcënimin për të “kopjuar Gazën nga Bejruti në kufi”, i bërë nga ministri i Mbrojtjes Gallant.

Times of Israel raportoi vlerësimet private të liderëve të ushtrisë izraelite, për faktin se milicët jemenas nuk duken të ndjeshëm ndaj parandalimit. Është pjesë e traditës shekullore të atyre fiseve kokëfortë, që luftojnë si të mos ketë të nesërme dhe nxjerrin në pah aftësi teknike të papritura.

Dhe vijmë te koka e oktapodit. Pas natës të dronëve dhe raketave më 13 prill, Teherani ka shmangur përplasjet e drejtpërdrejta me Izraelin. Megjithatë, ai ka shumëfishuar dërgesat e armëve të avancuara te Houthit dhe po përpiqet t'i transferojë te Hezbollahu. Kjo mbetet përplasia, e lidhur kryesisht me të ardhmen e Shtëpisë së Bardhë: Biden ka bërë gjithçka për të kufizuar konfliktin, me Trumpin gjërat mund të ndryshojnë. / bota.al



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



# Alpinistja Uta Ibrahimi ngjitet në majën e fundit 8 000 metra në Pakistan



Himalayas, 23 korrik - Majat 8 000 metra në Pakistan janë një grup unik malesh. Alpinistët duhet të presin të kalojnë rreth 60 ditë në ekspeditat e tyre në Pakistan. Uta Ibrahimi, alpinistja e Kosovës, u ngjit në majën e 12-të - 8000 metërshe në Himalaje. Përkundër vështirësive me oksigjen, ajo arriti ta realizojë ngjitjen me qetësi dhe në gjendje të mirë shëndetësore. Gasherbrum II, i njohur gjithashtu si K4, është mali i 13 më i lartë në botë, që qëndron në lartësi prej 8,035 metra dhe ndodhet në krye të akullnajës Baltoro në Pakistan. Ndodhet në vargmalin Karakoram në kufirin midis

Pakistanit dhe Kinës, midis majave të tjera 8 000 metra të Pakistanit, si K2, Gasherbrum I dhe Broad Peak. Me ngjitjen e G2 Uta Ibrahimi, kompletton ngjitjen e të gjitha majave 8 000 metërshe që ndodhen në Pakistan: K2 - 8,611 metra, Nanga Parbat - 8,126 metra, Gasherbrum I - 8080 metra, Broad Peak - 8051 metra, Gasherbrum II - 8,035 metra. Emri "Gasherbrum" rrjedh nga fjalët Balti "rgasha" (e bukur) dhe "brum" (mal), duke përkthyer kështu "Mali i bukur". Sot Gasherbrum II vazhdon ta tërheqë alpinistë nga e gjithë bota. Përparimet në teknologjinë e ngjitjes,

parashikimin e motit dhe logjistikën e kanë bërë ngjitjen më të menaxhueshme, por ajo mbetet një sfidë e madhe që kërkon respekt. Mali është, gjithashtu, pjesë e dialogut më të gjerë rreth ndikimeve të ndryshimeve klimatike, pasi akullnajat në Karakoram po monitorohen nga afër për shenja tërheqjeje dhe ndryshime të tjera. Momentalisht Uta ndodhet në kampin bazë pas 30 orë ngjitje nga kampi 2 drejt majës, dhe nga kampi bazë do t'i duhen 4 ditë të tjera që të arrijë në qytet prej ku pastaj kthehet për në Kosovë.

## SHKURT

### Robert Rikiqi përforcon KB Bashkimi

Robert Rikiqi është përforcimi i parë i huaj i KB Bashkimi. Lajmin e ka dhënë klubi prizrenas. Ai së fundi ishte lojtar i Rabotniçkit të Maqedonisë së Veriut, ndërsa më herët ka luajtur edhe në Mal të Zi, Bosnjë-Hercegovinë, Kroaci dhe Çeki. "Gjithashtu, Rikiqi ka luajtur gjashtë vjet në ABA Ligë me ekipet si Zagreb, Shiroki, Budućnost dhe Igokea", shkruan në njoftimin e Bashkimit. Ai në kampionatin e Maqedonisë së Veriut luajti me mesatare prej 15,4 pikë dhe 9,2 kërcimesh.

### Manaj: Ndihej mirë te Sivasspori

Sulmuesi i Kombëtares së Shqipërisë, Rei Manaj, ka nisur stërvitjen me Sivassporin, pavarësisht prej thashethemeve për një lagim të mundshëm. "Ndihej shumë mirë. Jam shumë i lumtur që jam kthyer këtu. Kam qenë gjithmonë në komunikim me Sivassporin për transferimin tim. Ata nuk donin të më dërgonin nën vlerën time. Evropiani ishte shumë i mirë për mua. Momentet më të mira të jetës sime i kam kaluar me fanellën e vendit tim. Por tani jam në Sivasspor me gjithë përqendrimin tim", ka thënë Manaj.

### Astrit Selmani në formacionin e javës në Rumani

Astrit Selmani e ka nisur në mënyrën më të mirë të mundshme sezonin në elitën e futbollit rumun. Sulmuesi nga Kosova aktivizohet me fanellën e Dinamo Bukureshtit dhe ka qenë vendimtar në fitoren e skuadrës së tij. Dinamo Bukureshti ka triumfuar në xhiron e dytë 4-1 ndaj Petrolulit të Albin Berishës, derisa më meritori për këtë fitore të vendasve ishte sulmuesi kosovar. Selmani realizoi një gol dhe bëri dy asistime duke u shpallur në fund lojtari i ndeshjes. Falë paraqitjes fantastike, sulmuesi dardan ka zënë vend edhe në formacionin e javës nga "SofaScore", derisa ishte ndër lojtarët më të vlerësuar në elitën e futbollit rumun.

## Sadiku: Medalja olimpike është synim i madh, por unë dua ta bëj realitet

PRISHTINË, 23 KORRIK - Boksierja Donjeta Sadiku do ta përfaqësojë Kosovën në sportin e boksit në Lojërat Olimpike që do të zhvillohen në Paris të Francës. Atje ajo thotë se udhëton me një qëllim të vetëm, që të fitojë medalje olimpike dhe kështu ta realizojë ëndrrën e madhe të karrierës së

saj. "Kam punuar shumë për ta arritur normën olimpike. Unë prej fillimit, prej ciklit olimpik kur kam filluar stërvitjet, kam thënë që në këtë cikël olimpik synimi im nuk është vetëm kualifikimi, kështu që po shpresoj që të më prijë fati dhe të më realizohet ëndrra ime që e kam pasur gjatë gjithë karrierës

sime. Normalisht që është medalja olimpike. Medalja olimpike është fjalë e madhe, mirëpo po shpresoj shumë që të kem fat dhe të arrij ta bëj ëndrrën time realitet", ka thënë Sadiku. Përveç boksit, Kosova në këtë olimpiadë garon edhe në sportin e xhudos të notit dhe atë të atletikës.





## Tare: Dua të rikthehem

TIRANË, 23 KORRIK - Igli Tare ishte i ftuari special në "Sky Sport TG 24" në emisionin dedikuar transferimeve të lojtarëve. Për ish-drejtorin sportiv të Lazios goditjen më të rëndësishme deri më tani e

ka bërë Juventusin me afrimin e Kerpen Turam. Sipas Igli Tares, mesfushori francez do të jetë "surpriza" e kampionatit italian. Në lidhjen e bërë nga Tirana, Tare tregoi diçka më shumë rreth së ardhmes ku

pranoi se i mungonte shumë puna e përditshme, të cilën ka bërë për shumë vite në Romë. "Kur do të kthehem? Është një pyetje e bukur, por as unë nuk e di të jap një përgjigje të saktë. Dëshira sigurisht që nuk

më mungon, por nga ana tjetër nuk dua që të sforcuj gjërat pasi po pres për një projekt të rëndësishëm. Një projekt, i cili të më motivojë. Dëshira është e madhe që të rikthehem", ka thënë Tare.



## Bota kthen sytë kah Lojërat Olimpikë 'Paris 2024'



Paris, 23 korrik - Kur na ndajmë vetëm tri ditë nga ceremonia e hapjes, ethet e Lojërave Olimpikë "Paris 2024" po përfshijnë gjithë botën. 10 mijë e 714 sportistë nga 206 shtete do të konkurrojnë në 32 sporte për një numër total prej 329 eventesh, me aktivitetin që do të çelet zyrtarisht mbrëmjen e së premtes me një ceremoni madhështore përgjatë Lumit të Senës.

Presidenti i IOC, Thomas Bach, mbajti në Paris një fjalim para një delegacioni sportistësh të mbledhur në fshatin olimpik "Ju, atletë olimpikë, do të na tregoni se çfarë bota do të ishte sikur të jetonim të gjithë në të njëjtën frymë olimpikë të bashkëjetesës paqësore. Ju do të konkurroni kundër njëri-tjetrit, në të njëjtën kohë ju po jetoni të qetë së bashku nën një çati, këtu në fshatin olimpik. Ju po respektoni të njëjtat rregulla dhe, më e rëndësishmja, po respektoni njëri-

tjetrin. Në këtë mënyrë ju po i dërgoni botës një mesazh të fortë paqeje nga Parisi", u shpreh Bach. Pak ditë para fillimit të Lojërave Olimpikë "Paris 2024", fshatin olimpik e vizitoi edhe presidenti francez Emanuel Macron. Zona, e cila shtrihet në mbi 54 hektarë, përfshin gjithashtu komisariatit dhe stacionin e zjarrfikësve të ngritur brenda fshatit, teksa këto dy struktura u inauguruan zyrtarisht mëngjesin e djeshëm nga Macron. "Ne jemi krenarë për punën e madhe përgatitore dhe jemi të gatshëm të garantojmë siguri gjatë gjithë kohëzgjatjes së Lojërave. Janë mbi 250 mijë gra dhe burra që po sakrifikojnë kohën që kalojnë me familjet e tyre, ne kemi punuar prej vitesh për këtë eveniment. Një punë që do të ndryshojë territorin tonë dhe infrastrukturën do të mbeten trashëgimi. Ky fshat do të bëhet një lagje e vërtetë", deklaroi Macron. Të pranishëm ishin edhe ministri i

Brendshëm, Gerald Darmanin, dhe ministrja e Sporteve, Amelie Oudea-Castera.

Ndërkohë, Michel Platini, në një intervistë për "Midi Libre", në prag të Lojërave Olimpikë që do të mbahen në Paris, i befasoi të gjithë me deklaratën e tij: "Nuk do t'i shikoj ndeshjet e futbollit në 'Paris 2024'. Skuadra olimpikë e Francës nuk më intereson, pasi futbollit s'është një sport olimpik". Për ish-presidentin e UEFA-s, futbollit në Olimpiadë është futur vetëm për çështje interesash, duke qenë se mbush stadiumet.

### Historiku i medaljeve

Në prag të startit të "Paris 2024", ju pasqyrojmë dhjetëshen e parë të shteteve më fituese në historinë e Lojërave Olimpikë. Klasifikimin e komandojnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që kanë fituar plot 2636 medalje, më shumë sesa dyfishi në krahasim me vendin e dytë, ish-Bashkimin Sovjetik, që numëron 1010 medalje në total. Ndërsa për sa iu përket sportistëve më fitues në historinë e Lojërave Olimpikë, në radhët e meshkujve rekordin e mban notari legjendar amerikan Michael Phelps, me 28 medalje në vitet 2004-2016. Phelps regjistron 23 të arta, 3 të argjendta dhe 2 të bronzta. Për femra rekordin e mban ikona e gjimnastikës, Larisa Latynina, e cila mes viteve 1956-1964 ka fituar 18 medalje për Bashkimin Sovjetik: 9 ari, 5 argjendi dhe 4 bronz.

## Andy Murray paralajmëron pensionimin nga tenisi

LONDËR, 23 KORRIK - Dy herë kampioni olimpik në tenis, 37-vjeçari Andy Murray ka thënë se gara e tenisit në Lojërat Olimpikë "Paris 2024" do të jetë ngjarja e fundit e karrierës së tij. Murray, i konsideruar gjerësisht si një nga sportistët më të mëdhenj britanikë të gjitha kohëve, fitoi medaljen e artë olimpikë në vitin 2012 dhe 2016, përveçse fitoi tre tituj Grand Slam në një karrierë të shkëlqyer. Ai tashmë ka konfirmuar largimin nga tenisi pas Lojërave Olimpikë "Paris 2024". "Mbërrita në Paris për turneun tim të fundit të tenisit në Olimpiadë. Të



garoj për Britaninë ka qenë deri tani javët më të paharrueshme të karrierës sime dhe jam jashtëzakonisht krenarë që e bëj këtë për herë të fundit", ka shkruar Murray në X. Lojtari i lënduar dha një lamtumirë

emocionale në Wimbledon të këtij viti, vendi ku ai fitoi dy tituj të mëdhenj, pas një disfatë në dyshe me vëllanë e tij Jamie. Murray, i cili iu nënshtrua një operacioni më 22 qershor për të hequr një cyst të shtyllës kurrizore, i cili po i shtrengonte nervat dhe e bënte atë ta humbiste kontrollin dhe fuqinë në këmbën e tij të djathtë, kishte vendosur se nuk ishte mjaftueshëm i aftë për kërkesat e konkurrencës 1-she në All England Club. Gara e tenisit në Lojërat Olimpikë fillon më 27 korrik dhe Murray do të luajë si në lojërat teke ashtu edhe në dyshe.

### SHKURT

## Guardiola konfirmon se De Bruyne nuk largohet nga City

Pep Guardiola ka deklaruar se Kevin De Bruyne nuk do të largohet nga Manchester City këtë sezon. Reprezentuesi belg më parë ka qenë i lidhur me një lëvizje në Arabinë Saudite. Megjithatë, trajneri Guardiola tani ka thënë se 33-vjeçari nuk do të largohet. "Nëse dikush largohet, ne do të flasim për këtë", ka thënë ai. Skuadra e Arabisë Saudite, Al-Ittihad, thuhet se synon belgun i cili ka ende një vit në kontratën e tij me Manchester Cityn. Në qershor, De Bruyne i ka thënë gazetës belge "Het Laatste Nieuws" se po luante me idenë e një rroge fitimprurëse në fazat e fundit të karrierës së tij. "Këto janë edhe biseda që po i bëjmë gjithnjë e më shumë si familje. Më ka mbetur edhe një vit nga kontrata ime, ndaj duhet të mendoj se çfarë mund të ndodhë", ka deklaruar De Bruyne.

## Hojbjergu kalon te Marseille

Emile Hojbjerg është zyrtarisht lojtari më i ri i Marseilles. Klubi francez e zyrtarizoi përmes rrjeteve sociale huazimin për një sezon të mesfushorit danez nga Tottenham Hotspur. 28-vjeçari kalon te marsejezët për një shifër prej 15 milionë eurosh, me Marseille që ka mundësinë për ta blerë kartonin e Hojbjergut pas përfundimit të huazimit.

## LeBron Jamesi do ta mbajë flamurin e Amerikës në ceremoninë e hapjes së Olimpiadës

Komiteti Olimpik Amerikan ka zgjedhur LeBron Jamesin si sportistin që do ta mbajë flamurin në ceremoninë e hapjes së Lojërave Olimpikë "Paris 2024". Ylli 39-vjeçar i basketbollit amerikan e atij botëror do ta mbajë flamurin me vje dhe vija së bashku me një shoqëruese, që do të shpallet sot. Kjo e Parisit do të jetë Olimpiada e katërt për LeBronin, pas të bronzit në Athinë 2004 dhe dy medaljeve të arta në Pekin 2008 dhe Londër 2012. Në moshën 39 vjeçe, James do të bëhet basketbollisti i parë në historinë e ShBA-së që do ta udhëheqë paradën e sportistëve në ceremoninë e inaugurimit të Lojërave.

## Gundogan mund të largohet nga Barcelona

Pas një sezoni të parë shumë pozitiv në nivel individual, ndonëse i vështirë si ekip, Ilkay Gundogan mund ta lërë skuadrën e Barcelonës. Në fakt, pritet që mesfushori gjerman, tashmë 33 vjeç, të bëhet menjëherë një nga shtyllat e mesfushës së trajnerit të ri Hansi Flick. Siç shpjegohet nga "TV3", Gundogan ka marrë një propozim mjaft të mirë financiar nga Katari. Ekipi i Al-Sadd po përpiqet ta bindë gjermanin me një ofertë për tre sezonet e ardhshme. Një ofertë, e cila, përveç tundimit financiar, mund të lejojë në të njëjtën kohë Gundogan të kërkojë ta rinegociojë kontratën e tij aktuale me klubin "blaugrana". Kontrata aktuale me Barcelonën skadon më 30 qershor 2025. Në 51 ndeshje sezonin e kaluar me Barcelonën, mesfushori e kapiteni i Gjermanisë realizoi 5 gola. Për pasojë, klubi spanjoll kërkon të mbajë me çdo kusht mesfushorin që një vit më parë erdhi nga Manchester City.

## Aubameyang largohet nga Marseille, shkon në Arabinë Saudite

Pierre-Emerick Aubameyang ka vendosur të largohet nga Olympique Marseille pas vetëm një sezoni. Sulmuesi gabonez, i cili ka 27 gola dhe 11 asistime në 47 ndeshje, do të nisë një

aventurë të re në Arabinë Saudite, në Al Qadsiah, me ish-lojtarin e Chelseas, Borussia Dortmund, Barcelona dhe Arsenal e ka bërë të ditur me anë të një postimi në llogarinë e tij në "Instagram".

"Faleminderit Marseille! Kam pasur një vit plot emocione dhe dua ta falënderoj të gjithë klubin, stafin, shokët e skuadrës dhe tifozët tanë. Më keni ndihmuar, më keni bërë më të fortë dhe këto

kujtime do të mbeten me mua përgjithmonë. Ka ardhur koha që unë të filloj një kapitull të ri. Faleminderit zoti Frank Mçourt! Faleminderit Pablo që pranuat largimin tim! Faleminderit për

mbështetjen tuaj të pandërprerë, mbi të gjitha faleminderit që më dhatë mundësinë ta zbuloj ngrohtësinë dhe pasionin në Velodrome. Nuk do të të harroj kurrë", ka thënë ylli nga Gaboni.







**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA 1992







## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

